

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 1963 Rep.

Nr. 1020 Kol.



KONTRATE SHITJE KUOTE

Sot me date 09/07/2019 (dymije e nentembdhjete), ne Tirane, u paraqiten perpara meje noteres publike, Amela Mukaj, anetare e Dhomës së Noterisë Tiranë, me seli në me seli Bulevardi Blu, Godina "Arben Dedja", Kati 2 palet si me poshte vijon:

1. **Z. Albano Aliko**, i biri i Reshatit, lindur me 2/06/1969 ne Tirane dhe banues ne Tirane ne adresen; Njesia bashkiake nr. 10 Kavajes Pall i ri, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar nepermjet Kartes se Identitetit me nr. Personal G90602058E ortak i shoqerise "ASALB." shpk, regjistruar në QKB me date 10.05.1999 me NIPT J91710007J, me seli në adresën: KASHAR Autostrada Tirane-Durres, Km 7, ne rrugen dytesore prane QTU Tirane,

(ketu e me poshte "Shitesi");

Dhe

2. **SHOQËRIA "KASTRATI" SHPK** regjistruar në QKR me NIPT J 61813529P, me adresë Lagja 14, Rr. "Tiranës", Ura e "Dajlanit", prne gjykates se Apelit, Shkozet, Durrës, përfaqesuar nga Z. Shefit Kastrati, shtetas shqiptar, i biri i Jonuzit, lindur më datë 22.07.1970, në Brrut, Kukës, banues në Durrës, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 030721767 dhe Numer personal H00722126W madhor me zotësi të plotë juridike e për të vepruar,

(ketu e me poshte "Bleresi")

* **Dhënesja e pelqimit:**

Bashkeshortja e shitesit;

Zj. **AIDA ALIKO**, e bija e Lavdosh , e datelindjes 03/01/1976 lindur në Tirane dhe banues në adresen; Njesia bashkiake nr. 10 Kavajes Pall i ri, pajisur me letërnjoftimin (ID) me nr Personal H65103135Q madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar,

Shitesi dhe bleresi jane referuar me poshte individualisht si "**Pala**" dhe se bashku si "**Palet**".

MEQENESE:

- A. Shoqëria "ASALB." shpk eshte nje shoqeri regjistruar në QKB me date 10.05.1999 me NIPT J91710007J, me seli në adresën: KASHAR Autostrada Tirane-Durres, Km 7, ne rrugen dytesore prane QTU, Tirane, me kapital themeltar 100.000,00 (njqind mije) lek, kapital ne pronesi te ortakut Albano Aliko, i cili zoteron 50% te kuotave te kapitalit te shoqerise dhe ortakut Asllan Ramazan Muharremi, i cili zoteron 50% te kapitalit te shoqerise;
- B. Në bazë të Statutit të Shoqerise "ASALB" sh.p.k. ("**Statuti**") kuotat mund të transferohen me anë të shitblerjes.
- C. Nepermjet njoftimit te dates ____/____/2019 shitesi ka njoftuar ortakun e shoqerise Asllan Ramazan Muharremi ne respektim te se drejtes se tij per parablerjen e kuotes ne shitje te shitesit;
- D. Shitesi zotëron 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë ASALB shpk, te cilat ja ka ofruar per shitje bleresit, i cili ka pranuar t'i bleje.

- E. Duke u mbështetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë “ASALB” sh.p.k, Nr. ___ datë ___/___/2019, është vendosur miratimi i transferimit të kuotes së ortakut Albano Aliko, që perben pjesën e tij takuese prej 50% të kapitalit të shoqërisë me anë të kontratës së shitjes së kuotes, ku Z. Albano Aliko, shet 50% të kapitalit të shoqërisë tek blerësi;
- F. Në referim të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë “Kastrati” sh.p.k, Nr. ___ datë ___/___/2019, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë ka vendosur miratimin e blerjes së kuotes që përfaqëson 50% të kapitalit të shoqërisë “Asalb” sh.p.k me anë të kontratës së shitjes së kuotes.
- G. Me anë të kësaj kontrate Shitësi i transferon Blerësit me anë të shitblerjes së kuotes, 50% të kapitalit të Shoqërisë “ASALB” sh.p.k.
- H. Shitësi deklaron se do të bëhen të gjitha veprimet e nevojshme për të liruar kuotat nga çdo barre në QKB, nëse ka, për të mundësuar rregjistrimin e kësaj kontrate dhe transferimin e kuotes nga shitësi tek blerësi;
- I. Palët njohin, pranojnë e vërtetojnë se me nënshkrimin e kësaj kontrate zëvendësohet çdo Marrëveshje e Mëparshme mes paleve.
- J. Palet bien dakord për nënshkrimin e kësaj kontrate për shitjen e kuotes nëpërmjet Shitësit dhe Blerësit (“Kontrata për Shitjen e Kuotes” ose “Kontrata”), si më poshtë vijon:

Neni 1

Perkufizime

- 1.1 Përveç shprehjeve të tjera të perkufizuara ndryshe në këtë Kontratë, për qëllimet e saj, fjalet dhe shprehjet që vijojnë do të kenë kuptimin e mëposhtëm:

“Kontratë”	do të thotë kjo Kontratë për Blerje Kuote – duke përfshirë si pjesë perberese të saj, deklaratat paraprake të mesipërme;
“Shoqëria”	Shoqëria “ASALB.” shpk është një shoqëri regjistruar në QKB me datë 10.05.1999 me NIPT J91710007J, me seli në adresën: KASHAR Autostrada Tirane-Durres, Km 7, në rrugën dytesore pranë QTU, Tirane;
“Barre”	do të thotë çdo hipoteke, detyrim, peng, garanci, e drejtë zgjedhjeje, kufizim, e drejta e parablerjes, e drejta për t’u ofruar i pari në blerje, e drejta ose interesi i një pale të tretë, barre ose interesa siguroese të çdo lloji, ose çdo lloj tjetër marrëveshjeje preferenciale (duke përfshirë por pa u kufizuar në transferimin e një titulli ose të një marrëveshjeje kontrolluese) me efekte të ngjashme;
“Pala” ose “Palet”	do të thotë Blerësi ose Shitësi ose të dy së bashku, siç e kërkon përmbajtja;
“Cmimi i Blerjes”	do të thotë cmimi që Blerësi i paguan Shitësit për blerjen e Kuotes, siç përcaktohet në Nenin 2 të kësaj Kontrate;
“Kuota në Shitje”	është e barabartë me 50 % (pesëdhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 2

Objekti i Kontrates

- 2.1 Në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate (“Data e Nënshkrimit”), Shitësi i shet Blerësit dhe Blerësi blen nga Shitësi Kuotën në Shitje të lirë nga çdo Barre.
- 2.2 Cmimi i rene dakort për Kuotën në Shitje është cmimi prej 50.000 leke (pesëdhjetë mijë leke) dhe Cmimi i Blerjes në total për Kuotën në Shitje, është likujduar teresisht nëpërmjet paleve.

- 2.3 Kuota ne shitje do te transferohen juridikisht nga pronesia e Shitesit ne pronesi te Bleresit dhe pala Blerese do te behet zoteruesi ligjor i kuotes ne shitje menjehere pas rregjistrimit te kesaj kontrate prane QKB.

Neni 3

Deklarimet dhe Garancite e Shitesit

- 3.1 Shitesi deklaron dhe garanton ne lidhje me transaksionin qe parashikohet ne kete Kontrate, per te gjitha ceshtjet qe vijoje.
- 3.1.1 *Autorizimi* – Te gjitha veprimet, aktet dhe / ose procedurat e tjera te parashikuara nga legjislacioni shqiptar dhe / ose aktet e Shoqerise qe duhet te ndermerren nga ose per llogari te Shitesit dhe qe autorizojne Shitesin te lidhe dhe te zbatoje kete Kontrate jane kryer rregullisht. Kjo Kontrate eshte nenshkruar dhe dorezuar rregullisht nga Shitesi dhe perben nje detyrim te vlefshem dhe ekzekutiv per Shitesin dhe qe duhet zbatuar prej tij, ne perputhje me kushtet dhe afatet e Kontrates.
- 3.1.2 *Nenshkrimi* – Nenshkrimi i kesaj Kontrate nuk kerkon asnje depozitim, miratim, autorizim te cfaredo lloji nga ndonje autoritet shteteror ose pale e trete.
- 3.1.3 *Pronesia* – Shitesi eshte pronari i ligjshem i Kuotes ne shitje. Kuota eshte percaktuar dhe emetuar rregullisht si dhe jane shlyer plotesisht nepermjet kontributit ne para ne kapitalin themeltar te Shoqerise.
- 3.2 Shitesi garanton bleresin se gjendja financiare aktuale e shoqerise ne momentin e shitjes se kuotes eshte e njejte me ate qe i eshte bere me dije bleresit. Per cdo detyrim apo marredhenie me pale te treta te papasqyruara ne aktet e komunikuar nga shitesi tek bleresi, pergjegjes i vetem do te jete shitesi.
- 3.3 Shitesi garanton bleresin se nuk eshte pale ne ndonje marreveshje per te krijuar te drejta ne lidhje me kuoten.
- 3.3.1 Shitesi garanton bleresin se eshte pronar i ligjshem i pjeses se tij takuese ne kapitalin e shoqerise duke zoteruar titull te plote pronesie, te cilin e transferon nepermjet kesaj kontrate tek bleresi me te gjitha te drejtat e ortakut te shoqerise ASALB shpk, perfshire ketu marredhenjet kontraktore te lidhura me palet e treta, ku shoqeria eshte perfituese e te drejtave.
- 3.4 Shitesi garanton bleresin qe do te jete pergjegjes i vetem perpara bleresit per cdo detyrim apo marredhenje me pale te treta ne ngarkim te shoqerise, para dates se nenshkrimit te kesaj kontrate.
- 3.5 Shitesi garanton bleresin se mbi bleresin nuk rendon asnje detyrim i lindur mbi kuoten qe zoteron shitësi deri ne momentin e kalimit te pronesisë së tyre.
- 3.6 Shitësi heq dorë nga çdo pretendim në lidhje me fitimin që përfiton në formën e dividendit ose çdo përfitim tjetër deri në datën e transferimit të kuotes.

Neni 4

Deklarimet dhe Garancitë e Blerësit

- 4.1 Blerësi bën deklaramet dhe jep garancitë e mëposhtme Shitësit, secila prej tyre do të jetë e vertetë dhe e saktë.
- 4.1.1 *Autorizimi* – Të gjitha veprimet, aktet dhe/ose procedurat e tjera të parashikuara nga legjislacioni shqiptar dhe që duhet të ndërmerren nga ose për llogari të Blerësit dhe që autorizojnë Blerësin të lidhë dhe të zbatojë këtë Kontratë janë kryer rregullisht; kjo Kontratë është nënshkruar dhe dorëzuar rregullisht nga Blerësi

Neni 5

Ligji i zbatueshem dhe juridiksioni kompetent

- 5.1 Kjo kontratë, është hartuar në bazë të legjislacionit shqiptar dhe vençanërisht, dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe të Ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare” me ndryshimet përkatëse.
- 5.2 Çdo mosmarrëveshje që mund të lind nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj kontrate midis dy palëve, do të zgjidhen me bisedime dhe mirëkuptim të ndërsjelltë midis palëve në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 5.3 Kur midis palëve nuk arrihet zgjidhja e çështjeve me mirëkuptim, pala tjetër i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 6

Taksa dhe Shpenzime

- 6.1 Taksa për kalimin e aksioneve do të paguhet nga shitësi në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 6.2 Shpenzimet noteriale do të paguhet nga blerësi.

Neni 7

Te ndryshme

- 7.1 Cdo shtese, ndryshim, zgjidhje ose heqje dore nga ndonje prej dispozitave të kësaj Kontrate, do të jete e vlefshme vetëm nëse bëhet me shkrim, me akt noterial dhe nënshkruhet nga ose në emër të secilës Pale.
- 7.2 Në rast se një dispozite ose detyrim sipas kësaj Kontrate është i pavlefshëm, i paligjshëm ose i pazbatueshëm në një juridiksion, vlefshmeria, ligjshmeria dhe zbatueshmeria e dispozitave ose detyrimeve të tjera, ose e këtyre dispozitave ose detyrimeve në një juridiksion tjetër, nuk do të preket nga një fakt i tillë.
- 7.3 Palet do të përpiqen të zevendesojnë një dispozite të pazbatueshme ose të pavlefshme, në masën me të madhe të mundshme, për të arritur qëllimin e kësaj dispozite.
- 7.4 Kjo Kontrate nënshkruhet në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Sa sipër redaktohet kjo kontratë prej meje Noteres në 3 (tre) kopje të njëjta: nga një kopje i jepet secilës pale dhe një kopje ruhet në arkivin e noterit. Akti noterial hartohet në mbështetje të Ligjit nr.7829, datë 01.06.1994 “Për Noterine”, i ndryshuar, Kodit Civil, i lexohet paleve me ze të lartë, të cilët pasi e gjeten të redaktuar konform vullnetit të tyre të lire, e nënshkruan rregullisht në praninë time.

Une Noterja vertetoj nënshkrimin e tyre sipas ligjit.

PALA SHITËSE
ALBANO ALIKO

Albano Aliko
Aida Aliko

Dhenesi i pelqimit:
AIDA ALIKO

Aida Aliko
Aida Aliko

PALA BLERËSE
SHOQËRIA “KASTRATI” SHPK

[Signature]

NOTERE
AMELA Q. MUKAJ

[Signature]
[Stamp: NOTERË AMELA Q. MUKAJ]